



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

**RREGULLORE DIPLOMIMI E PROGRAMEVE STUDIMORE TË CIKLIT II
“MASTER I SHKENCAVE”**

Miratuar me Vendimin e Dekanatit

Nr. 150 datë 21.12.2021

Dhjetor 2021



1. Hyrje

Bazuar në ligjin për arsimin e lartë 80/2015 për të fituar diplomën e studimeve master, studentët që ndjekin Programet e ciklit të dytë të studimeve të ofruara nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës :

- **Master i Shkencave në Mësuesi:**

Mësuesi e Gjuhës **Angleze** për Arsimin e Mesëm të Lartë

Mësuesi e Gjuhës **Frënge** për Arsimin e Mesëm të Lartë

Mësuesi e Gjuhës **Gjermane** për Arsimin e Mesëm të Lartë

Mësuesi e Gjuhës **Italiane** për Arsimin e Mesëm të Lartë

Mësuesi e Gjuhës **Greke** për Arsimin e Mesëm të Lartë

Mësuesi s Gjuhës **Turke** për Arsimin e Mesëm të Lartë

- **Master i Shkencave në “Përkthim Teknik - Letrar dhe Interpretim”**

- **Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Komunikim Ndërkulturor e Turistik”**

përveç arritjes së rezultateve pozitive të kursit dhe kryerjes së praktikës profesionale, duhet t'i nënshtrohen edhe provës finale.

Punimi i diplomës është një punë kërkimore e cila realizohet në mënyrë individuale dhe të pavarur për një çështje a problem nga fusha e studimit përkatës, e cila paraqitet për mbrojtje pas përfundimit të programit. Ai synon të demonstrojë aftësitë analitike të studentit, aftësitë e tij për të integruar njohuritë teorike me materiale të ndryshme praktike, për të shprehur një qëndrim të caktuar profesional, provon zbatimin e një zgjidhjeje bazuar në të dhëna praktike, identifikon dhe strukturon probleme të reja, zhvillon zgjidhjen e një problemi ose prezanton ide dhe teori të reja. Ky manual përmban udhëzime për procedurat e përgatitjes, të udhëheqjes, të monitorimit, të prezantimit dhe të vlerësimit të punimit të diplomës si provë finale.



NENI 1

Objekti

Rregullorja e diplomimit të programeve studimore të ciklit të dytë “Master i shkencave” sipas emërtimeve të cituara në hyrje të kësaj Rregulloreje Diplomimi, ka për qëllim mbështetjen e organizimit të efektshëm të procedurave të përgatitjes, udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të punimit të diplomës master i shkencave.

Rregullorja e Diplomimit Cikli II në FGJH vendos rregullat normative të marrëdhënieve që krijohen midis subjekteve të përfshira në procesin e diplomimit, të cilat përcaktojnë të drejtat e detyrimet e diplomantëve, rregullat për organizimin e procesit si dhe raportet e tyre me organet drejtuese dhe strukturat e tjera të FGJH-së.

Rregullorja ka për qëllim të sigurojë kuadrin e brendshëm juridik të nevojshëm për mbarëvajtjen e procesit të diplomimit, të sigurojë rregulla të njëjta për disiplinën studentore dhe administrative, si edhe të garantojë standarde të cilësisë në hartimin e tezës së diplomës.

NENI 2

Baza Ligjore

Kjo rregullore është hartuar bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr 80/2015, Statutin e Universitetit të Tiranës, Rregulloren e Universitetit të Tiranës.

NENI 3

Parakushte të marrjes së temës së Diplomës

Parakusht për fitimin e Diplomës së Ciklit të dytë të studimeve në të gjitha programet studimore “Master i Shkencave” të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja është shlyerja nga kandidati e të gjitha detyrimeve të lëndëve, sipas parashikimeve në planin mësimor të programit të studimit.



NENI 4

Fusha e Veprimit

Rregullorja shtrin efektet e saj në të gjitha strukturat, organet dhe autoritetet drejtuese të njësisë kryesore, njësitë bazë përbërëse, personelin akademik, personelin joakademik dhe studentët. Kjo Rregullore është hartuar në përputhje me planin mësimor të programit të studimit duke respektuar lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik, të studentëve dhe të legjislacionit në fuqi.

NENI 5

Të dhëna të përgjithshme për punimin e diplomës

Punimi i diplomës së masterit të shkencave si rregull përgatitet individualisht nga studenti. Studentit i kërkohet të bëjë një hulumtim të pavarur për një problematikë që lidhet me fushën e studimit të programit Master i Shkencave. Studentët duhet të jenë të aftë të bëjnë hulumtim dhe të raportojnë në lidhje me të gjithë procesin e hulumtimit, i cili kurorëzohet me tekstin përfundimtar të punimit të diplomës Master i Shkencave. Ata fillojnë me identifikimin e problemit të studimit, mbledhjen e të dhënave, metodat e analizës së të dhënave etj, dhe në fazat e mëvonshme, përshkruajnë rezultatet e hulumtimit, sintetizojnë të dhënat, nxjerrin përfundimet dhe ofrojnë rekomandimet përkatëse.

Punimi i diplomës së masterit u ofron studentëve para së gjithash:

- njohuri më të gjëra dhe më të thella në një fushë të veçantë;
- njohuri dhe përvojë në procesin e hulumtimit;
- përvojë për të gjetur dhe hulumtuar burimet e informacionit në një fushë të caktuar;
- aftësi të përmirësuara për të interpretuar në mënyre kritike një temë të zgjedhur;
- aftësi të përmirësuara për organizimin e rezultateve të një hulumtimi në formë të shkruar dhe gojore etj.

Punimi i shkruar në kuadër të programeve Master i Shkencave duhet të jetë një kontribut i rëndësishëm dhe origjinal. Kjo detyrë bazohet në standarde rigoroze sa i përket metodologjisë, mënyrës së prezantimit dhe etikës së kërkimit.

Rekomandohet që studenti të përzgjedhë disa tema të mundshme dhe me ndihmën e udhëheqësit të zgjedhë njërin prej tyre. Është e rëndësishme që në këtë fazë të shfletohet një literaturë e gjerë që ka lidhje me temën, në mënyrë që studenti të njihet me arritjet dhe diskutimet në atë fushë. Kur kandidati dhe udhëheqësi i tij përcaktojnë përfundimisht temën e punimit, ai duhet të paraqesë projekt-propozimin për punimin kërkimor (*shih Shtojca 1*).



NENI 6

Udhëheqja e diplomës

Çdo student/e ka të drejtë të zgjedhë një udhëheqës shkencor. Udhëheqësi shkencor që të udhëheqë punën e studentit duhet të ketë gradë shkencore "Doktor". Në parim, udhëheqësi shkencor duhet të zgjidhet nga punonjësit akademikë ose shkencorë të fakultetit dhe duhet të ketë përvojë në fushën në të cilën do të kryhet punimi i diplomës. Pasi merr pëlqimin e udhëheqësit, projekt-propozimin për punimin dhe udhëheqësin student/i/ja ia paraqet departamentit përkatës.

Të gjitha temat e diplomës së programeve studimore të Ciklit II, Master i shkencave, bëhen nën drejtimin e një pedagogu si udhëheqës i temës. Gjithashtu, temat e diplomave kanë edhe një pedagog oponent, i cili paraqet me shkrim vlerësimin e tij.

Për të garantuar cilësinë e udhëheqjeve si edhe për respektuar parimin e barazisë, në raport të drejtë me numrin e personelit akademik specialist të fushës përkatëse të temës së propozuar, kërkesat e studentëve të programit të studimit për fushën përkatëse, Departamentet, me kolegjalitet, caktojnë kufij të numrit maksimal të studentëve të cilët mund të udhëhiqen nga një pedagog.

NENI 7

Përgjegjësitë e udhëheqësit

Udhëheqësi shkencor ka këto përgjegjësi:

- Të garantojë se do të zbatojë të gjitha rregullat e udhëheqjes së punimit.
- Të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatit të arrijë standarde të larta të punimit. Kjo përfshin ndihmën për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve dhe përgatitjen e punimit. Udhëheqësi e ndihmon studentin të përmirësojë stilin e të shkruarit, por nuk ka përgjegjësi që të bëjë redaktimin e materialit. Udhëheqësi ka përgjegjësinë të ndërgjegjësojë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe të plagjiaturës.
- Të garantojë se udhëheqja do të kryhet brenda kohës së parashikuar.
- Të mbajë takime të rregullta me studentin (të paktën 1 takim në javë, në orarin e pritjes me studentët) për të dhënë këshilla dhe për të qenë në dijeni të ecurisë së punimit.



- Të vlerësojë progresin e studentit rregullisht duke i kërkuar atij të paraqesë një raport të shkruar dhe të monitorojë punën e tij përkundrejt standardit të kërkuar. Të vetëdijësojë studentin nëse puna e tij është nën standardin e kërkuar dhe të ndërmarrë veprimet e duhura mbështetëse.
- Të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndihmuar studentin në përgatitjen e punës së tij që do të prezantohet në seminare ose takime.
- Të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndihmuar studentin për përgatitjen e prezantimit të punimit të tij para komisionit të mbrojtjes. Të vlerësojë tezën e diplomës së dorëzuar. Vlerësimi me shkrim konsideron pajtueshmërinë e materialit me kërkesat formale dhe përmbajtjen e kërkuar, dhe përfshin vlerësimin e punës së studentit. Udhëheqësi e vlerëson tezën e diplomës së studentit me shkëlqyeshëm, shumë mirë dhe mire. (Shtojca 5).
- Të bëjë kritikën e duhura për punimin e studentit dhe komentet konstruktive brenda kohës së caktuar dhe në kohën e mbrojtjes së punimit të konfirmojë se punimi i plotëson kërkesat dhe standardet e kërkuara për fitimin e diplomës.
- Të vërtetojë se kandidati i ka plotësuar të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e komisionit të vlerësimit kur ai e ka kthyer punimin për riparimitje.
- Të nxisë studentin që ai të botojë pjesë nga punimi i tij.
- Të menaxhojë fondet e kërkimit nëse janë siguruar të tilla.

NENI 8

Përgjegjësitë e studentit

Studenti ka këto përgjegjësi:

- Të jetë i familjarizuar me rregullat e procedurave të provës finale.
- Sapo të ketë përcaktuar llojin dhe temën e punimit, studentin duhet të kërkojë një udhëheqës, si rregull nga personeli akademik i departamentit përkatës.
- Të zbatojë standardet shkencore dhe etike të parashikuara për provën finale.
- Të punojë sistematikisht dhe të bëjë të gjitha përpjekjet për të përfunduar punimin në kohën e duhur.
- Studenti duhet t'i paraqesë udhëheqësit, një raport të punës së kryer çdo muaj.



NENI 9

Procedura e propozimit të punimit të diplomës

Në fund të semestrit të parë, të vitit të dytë të programit studimor master i shkencave, pasi është njoftuar me email nga Departamenti përkatës për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së temës dhe të udhëheqësit, studenti duhet të dorëzojë projekt- propozimin për punimin e diplomës pranë departamentit. Projekt-propozimi për provën finale paraqitet duke plotësuar një formular të veçantë, i cili i dërgohet me email nga departamenti i tij (Shih Shtojca 1).

Në një afat prej 15 ditësh pas dorëzimit të Projekt-propozimit të punimit shkencor, shqyrtohet në Departament përshtatshmëria e propozimit me kërkesat për provën finale, raporti udhëheqës/studentë, dhe miratohet udhëheqësi i punimit.

Në raste të jashtëzakonshme dhe për shkaqe të arsyeshme, kandidati mund të kërkojë ndërrimin e udhëheqësit. *Ndërrimi i udhëheqësit bëhet me kërkesë të studentit e cila i paraqitet Përgjegjësit të njësisë bazë, i cili merr vendimin pasi e shqyrton atë dhe mbasi dëgjon edhe udhëheqësin e temës.*

Titulli i punimit të miratuar regjistrohet në regjistrin e punimeve të diplomës, pranë departamenteve.

NENI 10

Konsultimet

Gjatë procesit të shkruarit të punimit, studenti duhet të ketë konsultime të rregullta me udhëheqësin e tij/e saj. Nuk është mirë që kandidati të punojë një kohë të gjatë në mënyrë të pavarur dhe pastaj të konsultohet me udhëheqësin dhe t'i dorëzojë një pjesë të madhe të punimit, pa marrë mendimin dhe sugjerimet e tij për çdo kapitull të tij. Konsultimet janë gjithashtu detyrim edhe për udhëheqësit.



NENI 11

Dorëzimi i tekstit përfundimtar të punimit

Studenti ka detyrimin t'i dorëzojë udhëheqësit një kopje të punimit para përgatitjes së tekstit final të punimit. Kopja e dorëzuar duhet të jetë e rregullt nga pikëpamja gjuhësore dhe stilistikore dhe e plotë sipas strukturës së miratuar. Ndryshimet e rekomanduara apo të kërkuara duhet të merren në konsideratë dhe të pasqyrohen në tekstin përfundimtar.

Pas kësaj, teksti përfundimtar i shkruar në një format dhe stil të përcaktuar në përputhje me *Nenin 18: Modalitete të shkrimit të punimit të diplomës* të kësaj Rregulloreje, duhet të dorëzohet në departamentin përkatës (pasi udhëheqësi të ketë dhënë miratimin e tij me shkrim që punimi është i përfunduar dhe i gatshëm për t'u mbrojtur *shih Shtojca 4*).

Punimi dorëzohet 3 javë përpara datës së mbrojtjes në 2 (dy) kopje. Studentët, të cilët nuk respektojnë këto afate, nuk mund të bëjnë mbrojtjen e temës në sezonin e rregullt të verës. Ata kanë mundësi të paraqiten në sezonin pasardhës.

Kopjet përfundimtare të punimit dorëzohet në department në afatet e caktuara paraprakisht dhe të bëra publike nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të fakultetit si edhe nëpërmjet lajmërimit në email, dhe shpalljes së datave të mbrojtjes në vende të dukshme. Kopjet e punimit i jepen komisionit të posaçëm për komente dhe vlerësim të bashkuar me CD.

NENI 12

Komisioni dhe Vlerësimi

Komisioni i mbrojtjes së diplomës përbëhet nga 3 (tre) pedagogë, prej të cilëve njëri është oponent dhe dy të tjerë duhet të jenë të fushës përkatëse. Si rregull, udhëheqësi është pjesë e komisionit vlerësues. Komisioni miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Vlerësimi kryhet duke marrë parasysh vlerësimin e oponentit, udhëheqësit dhe anëtarit tjetër të komisionit. Vlerësimi përfundimtar i punimit të diplomës kryhet në përputhje me kriteret e vlerësimit sipas përcaktimeve në *Nenin 17, Kriteret e vlerësimit të punimit të diplomës master i shkencave të kësaj Rregullore Diplomimi*.

Shkalla e vlerësimit të punimit të diplomës ndjek sistemin e vlerësimit prej 10 (dhjetë) notash. Nota më e lartë është 10 (dhjetë) dhe ajo më e ulët kaluese 5 (pesë).

Vlerësimi përfundimtar i punimit të diplomës nuk mund të ankimohet.



NENI 13

Mbrojtja e diplomës

Mbrojtja e Temës së Diplomës bëhet publike dhe konsiston në një punim me shkrim. Ky punim presupozohet të përbëjë rezultatin e një kërkimi me origjinalitet shkencor, si nga pikëpamja e përzgjedhjes së argumentit ashtu edhe për nga metodologjia e kërkimit;

Mbrojtja bëhet në gjuhën e shkrimit të Temës së Diplomës, në gjuhën B, gjuha e huaj e parë e studimit.

Mbrojtja realizohet në praninë e udhëheqësit dhe të anëtarëve të Komisionit. Studenti e mbron temën e masterit, me gojë, para një komisioni të propozuar nga përgjegjësi i departamentit.

Studentit zakonisht i jepet 15-20 minuta kohë për të paraqitur rezultatet e hulumtimit të tij (duke përdorur kompjuterin ose mjete e teknika të tjera sipas nevojës). Pas prezantimit të studentit, oponenti i punimit shpreh mendimin e tij në lidhje me punimin. Mendimi i oponentit dorëzohet me shkrim në departament. Anëtarët e tjerë të komisionit mund të drejtojnë pyetje rreth temës. Edhe Udhëheqësi i punimit jep vlerësimin e tij në lidhje me cilësitë e punimit dhe punën e kryer nga kandidati. Kandidati ka të drejtë të kërkojë pak kohë në mënyrë që të përgatisë përgjigjet. Komisioni i dëgjon përgjigjet dhe jep komentet e tij lidhur me to, ose kërkon shpjegime shtesë. Në parim, nuk mund të bëhen pyetje të çfarëdoshme. Në fund, komisioni tërhiqet për t'u konsultuar për vlerësimin e punimit të shkruar të kandidatit dhe mbrojtjen e bërë prej tij /saj dhe shpall publikisht rezultatin, rezultat i cili i komunikohet prej komisionit individualisht kandidatit.

NENI 14

Tipologji të temës së diplomës në programin studimor Master i Shkencave në PËRKTHIM TEKNIK - LETRAR DHE INTERPRETIM

Temë nga fusha e Përkthimit letrar: Tema nga fusha e Përkthimit letrar, do të konsistojë në përkthimin e një teksti letrar prej 30 faqesh A4 (2000 karaktere për çdo faqe), me vështirësi të lartë nga njëra prej dy gjuhëve të përzgjedhura nga vetë studenti në gjuhën shqipe. Teksti që do të përkthehet, mund të shoqërohet edhe nga një studim historik i gjuhës së përzgjedhur prej tij. Teksti i përkthyer duhet të integrohet me një projekt të detajuar prej 10 faqesh A4 (motivimet kritike dhe tipologjia e strategjive të përdorura), i cili duhet të jetë koherent dhe të ndjekë rregullin metodologjik.



Temë nga fusha e Përkthimit teknik: Tema nga fusha e Përkthimit teknik, do të konsistojë në përkthimin e një teksti teknik prej 30 faqesh A4 (2000 karaktere për çdo faqe), me vështirësi të lartë nga njëra prej dy gjuhëve të përzgjedhura nga vetë studenti në gjuhën shqipe. Teksti do të shoqërohet nga skedat e realizuara për çdo term dhe glosari i përgjithshëm i terminologjisë me të gjitha shpjegimet e duhura dhe burimet e shfrytëzuara.

Temë nga fusha e Përkthimit të krahasuar: Tema nga fusha e Përkthimit të krahasuar, do të konsistojë në përgatitjen e një studimi prej 40 faqesh që do të ngërthejë krahasimin e teksteve të llojeve të ndryshme (letrar, pragamatik, tekniko-shkencor etj) në njërën prej dy gjuhëve të huaja, të përzgjedhur nga vetë studenti të përkthyer në gjuhën shqipe dhe anasjelltas, duke u përqëndruar në analizën e detajuar të tekstit origjinal me tekstin e përkthyer, analizë që duhet të ngërthejë aspektet kuptimore, gramatikore dhe stilistikore.

NENI 15

Tipologji të temës së diplomës në programin studimor Master i Shkencave në GJUHË DHE KOMUNIKIM NDËRKULTUROR E TURISTIK

Temë në fushën e Letërsisë dhe të Kulturës: Studenti duhet të përgatisë një punim me shkrim 60 faqe A4 (2000 karaktere për çdo faqe) në fushën e letërsisë apo të kulturës të përzgjedhur nga ai vetë. Punimi duhet të jetë origjinal dhe të ngërthejë fushën kërkimore-shkencore sipas programit që ai ka shlyer në ciklin e dytë.

Temë në fushën e Komunikimit turistik: Studenti duhet të përgatisë një punim me shkrim 60 faqe A4 (2000 karaktere për çdo faqe) në fushën e komunikimit turistik (promovim turistik, udhërrëfyesa, drejtim ndërmarrje turistike etj). Punimi duhet të jetë origjinal dhe të ngërthejë fushën kërkimore-shkencore sipas programit që ai ka shlyer në ciklin e dytë.

Temë në fushën e Komunikimit: Studenti duhet të përgatisë një punim me shkrim 60 faqe A4 (2000 karaktere për çdo faqe) në fushën e Komunikimit (komunikim ndërinstitucional, komunikim ndërkulturor, komunikim ndërpersonal etj). Punimi duhet të jetë origjinal dhe të ngërthejë fushën kërkimore-shkencore sipas programit që ai ka shlyer në ciklin e dytë.



NENI 16

Tipologji të temës së diplomës në programet studimore Master i Shkencave në

- Mësuesi e Gjuhës ANGLEZE për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Mësuesi e Gjuhës FRËNGE për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Mësuesi e Gjuhës GJERMANE për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Mësuesi e Gjuhës ITALIANE për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Mësuesi e Gjuhës GREKE për Arsimin e Mesëm të Lartë
- Mësuesi e Gjuhës TURKE për Arsimin e Mesëm të Lartë

Temë metodike në mësimdhënie të gjuhës së huaj për moshë dhe klasë të ndryshme: Studenti duhet të përgatisë një punim me shkrim 50 faqe A4 (2000 karaktere për çdo faqe) në fushën e Mësimdhënies të gjuhës së huaj për moshë dhe klasë të ndryshme, të përzgjedhur nga ai vetë. Punimi duhet të jetë me përmbajtje origjinale dhe të ngërthejë fushën kërkimore-shkencore sipas programit që ai ka shlyer.

Temë në fushën e kërkimit në Gjuhësinë e aplikuar: Studenti duhet të përgatisë një punim me shkrim 50 faqe A4 (2000 karaktere për çdo faqe) në fushën e kërkimit në Gjuhësinë e aplikuar të përzgjedhur nga ai vetë. Punimi duhet të jetë me përmbajtje origjinale dhe të ngërthejë fushën kërkimore-shkencore sipas programit që ai ka shlyer.

Temë teorike krahasuese në fushën e Mësimdhënies dhe të përvetësimit të gjuhës së huaj: Studenti duhet të përgatisë një punim teorik krahasues, me shkrim 50 faqe A4 (2000 karaktere për çdo faqe) në fushën e Mësimdhënies dhe të përvetësimit të gjuhës së huaj, të përzgjedhur nga ai vetë. Punimi duhet të jetë me përmbajtje origjinale dhe të ngërthejë fushën kërkimore-shkencore sipas programit që ai ka shlyer.

Temë kërkimore në fushën e Edukimit gjuhësor dhe ndërkulturor: Studenti duhet të përgatisë një punim me shkrim 50 faqe A4 (2000 karaktere për çdo faqe) në fushën e studimeve për Edukimin ndërgjuhësor dhe ndërkulturor, të përzgjedhur nga ai vetë. Punimi duhet të jetë me përmbajtje origjinale dhe të ngërthejë fushën kërkimore-shkencore sipas programit që ai ka shlyer.



NENI 17

Kriteret e vlerësimit të punimit të diplomës Master i Shkencave

Rekomandohet që për vlerësimin e punimit të diplomës master i shkencave të mbahen parasysh kriteret e mëposhtme: (shih Shtojca 6)

Cilësia e shkrimit, organizimi, stili, parashtrimi dhe zhvillimi i ideve

- Organizimi logjik
- Diskutimi koherent dhe vlerësimi kritik i problemeve dhe ideve;
- Përshkrimi i kujdesshëm i problemeve, çështjeve, apo pyetjeve të ngritura, duke përfshirë metodologjitë dhe epidemiologjinë e kërkimit që janë përdorur etj;
- Cilësia e të shkruarit (respektimi i stilit shkencor të të shkruarit, respektimi i rregullave të drejtshkrimit, stili i përshtatshëm formal dhe akademik).
- Lexueshmëria e diagrameve, grafikëve dhe ilustrimeve, qartësia e fotografive.

Rëndësia e problemeve, çështjeve apo pyetjeve të ngritura në punim: Problemet, çështjet ose pyetjet e ngritura duhet të jenë të tilla që përbëjnë shqetësim aktual/ të vazhdueshëm në një fushë të caktuar. Potenciali i studimit për të shtuar qasje të reja.

Cilësia e analizës: Analizë domethënëse e problemeve, çështjeve dhe pyetjeve të ngritura në lidhje me informacionin, materialin dhe të dhënat e mbledhura;

- Të marrë në konsideratë kufizimet dhe karakterin përgjithësues të studimit;
- Analizë të paanshme dhe reale të çështjeve të trajtuara;
- Analizë cilësore e cila të mund të nxjerrë në dukje problemet reale të çështjes, e cila është objekt studimi.
- Të marrë në konsideratë kufizimet dhe karakterin përgjithësues të studimit.

Cilësia e përfundimeve dhe/ose e rezultateve: Lidhja e teorisë me praktikën;

- Parashtrimi i pyetjeve për hulumtime të mëtejshme;
- Trajtim real, objektiv dhe i paanshëm i çështjeve;
- Dobishmëria e rezultateve të punimit për studime të mëtejshme;
- Rezultatet e punimit duhet të jenë një përfundim logjik i trajtimit të temës;
- Nxjerrje të rezultateve reale duke u bazuar në burime kredibile dhe reale për trajtimin e temës;
- Aktualitet në trajtimin e temës.



Koherenca, karakteri krijues dhe originaliteti

- Artikulimi i qartë i problemeve, çështjeve dhe pyetjeve të ngritura në punim si dhe arsyetimi pse këto probleme, çështje dhe pyetje duhet të studiohen;
- Formulim origjinal i temës;
- Këndvështrim origjinal i temës;
- Punë e pavarur, krijueshmëri dhe rezultate konkrete;
- Dobishmëria shoqërore, kontributi për studime të mëtejshme në lëminë përkatëse.

Paraqitja gjithëpërfshirëse e literaturës ekzistuese: Rishikim i literaturës në mënyrë logjike dhe krijuese duke artikuluar qartë:

- a) zhvillimin historik të problemeve, çështjeve dhe pyetjeve të ngritura në studim
- b) tendencat e kohës, shkollat e mendimit dhe këndvështrimet e ndryshme që kanë të bëjnë me temën.

Trajtimi i literaturës së analizuar shkon përtej kufijve të një përmbledhjeje, por në mënyrë kritike vlerëson kufizimet dhe mundësitë e literaturës së mëparshme në lidhje me studimin.

Parashtrimi logjik në paraqitje dhe metodologji; Përshkruan dhe ofron arsyetimin për përshtatshmërinë, mundësitë dhe kufizimet e metodologjive, metodave të kërkimit dhe të epistemologjisë apo epistemologjive të kërkimit të përdorura për zhvillimin e kuadrit konceptual të punimit.

- Mënyra e përdorimit dhe efikasiteti i instrumenteve të kërkimit shkencor;
- Përcaktimi i objektit të studimit në përputhje me temën e studimit;
- Përcaktimi i hipotezave dhe çështjeve kërkimore;
- Përcaktimi i subjekteve, kampioneve, si dhe përzgjedhja e metodave dhe instrumente të përshtatshëm.

Përfundimet: Në mënyrë kritike trajton karakterin përgjithësues dhe aplikativ të studimit dhe kontributin e tij në zgjerimin e kufijve të kërkimeve të mëparshme, sa i përket origjinalitetit në kërkim.



NENI 18

Modalitete të procedurave dhe shkrimit të punimit të diplomës Projekt-propozimi i temës së punimit të diplomës Master i Shkencave.

Projekt-propozimi paraqet planin e hollësishëm kërkimor të studentit. Nëse ky plan është problematik në një apo më shumë hallka të tij, atëherë ka gjasa për mosrealizimin me sukses të tij. Për këtë arsye, hartimi i projekt-propozimit duhet të konsiderohet si një detyrë mjaft serioze. Në këtë fazë, udhëheqësi duhet t'i japë një ndihmë të madhe studentit.

Në përmbajtjen e një projekt-propozimi të punimit të diplomës së Programit të studimit "Master i Shkencave" përfshihen:

- Titulli i temës
- Abstrakti
- Fjalët kyçe
- Hyrja
- Sfondi teorik
- Formulimi i problemit dhe qëllimet e hulumtimit
- Pyetjet dhe hipoteza e hulumtimit
- Metodatat dhe teknikat e hulumtimit
- Rezultatet e hulumtimit
- Literatura

Projekt-propozimi i punimit të diplomës nuk duhet të ketë më shumë se 7 faqe.

Struktura e punimit shkencor

Punimi shkencor duhet të përbëhet nga këto pjesë kryesore:

- Abstrakti
- Mirënjohja
- Tabela e përmbajtjes
- Studimi
- Hyrja
- Lista e tabelave, diagrameve, shtojcave
- Shqyrtimi i literaturës së fushës dhe të çështjes
- Metodologjia
- Rezultatet e studimit
- Diskutimi
- Përfundime dhe propozime
- Bibliografia (literatura)
- Shtojca



Titulli i temës: Titulli i temës duhet të jetë i shkurtër dhe i qartë (në parim, jo më i gjatë se 20 fjalë). Titulli duhet të përkojë me përmbajtjen e vërtetë të temës dhe të tërheqë lexuesit. Duhet shmangur fjalët dhe shprehjet e përgjithshme (abstrakte) dhe duhet të formulohet një titull konkret dhe specifik për fushën e studimit.

Çdo titull punimi diplome i formuluar dhe i miratuar si i tillë, krahas formulimit në gjuhën e huaj B, propozohet nga kandidati në bashkëpunim me udhëheqësin edhe në gjuhën angleze.

Abstrakti: Tema e studimit paraqitet përmes një abstrakti i cili paraqet përkufizimin e problemit, pse është i rëndësishëm studimi (në lidhje me diskutimet bashkëkohore në fushën e studimit), cila është hipoteza e përgjithshme, metodat, instrumentet dhe rezultatet e pritshme. Në parim, abstrakti nuk duhet t'i tejkalojë 350 fjalë.

Fjalët kyçe: Fjalët kyçe janë terma përshkrues në lidhje me temën e studimit. Në parim duhet të jenë 5-6 fjalë. Këto vendosen në fund të abstraktit.

Hyrja: Në hyrje bëhet një paraqitje e hollësishme e rëndësisë së problemit që do të jetë në qendër të studimit (hulumtimit) dhe shpjegohen arsyet që e kanë nxitur kandidatin/en për zgjedhjen e temës dhe trajtimin e një problemi të caktuar.

Sfondi teorik: Në këtë pjesë kandidati bën një përshkrim të përgjithshëm të "fushës së studimit" dhe e vendos temën e propozuar në kuadër të saj. Këtu është e domosdoshme të paraqiten, krahasohen dhe vlerësohen teoritë më të rëndësishme që lidhen me temën e propozuar. Rekomandohet të përmendet literatura dhe studimet që lidhen me temën e punimit të diplomës (libra, artikuj, raporte hulumtuese) të autorëve të tjerë (kombëtare dhe ndërkombëtare) duke u përqëndruar kryesisht në rezultatet dhe përfundimet e tyre. Studimet më të reja (p.sh. të botuara gjatë këtij dhjetëvjeçari) duhet të vendosen në radhë të parë. Kandidati/ja duhet të bëjë të qartë se çfarë dihet në fushën përkatëse të hulumtimit (në lidhje me temën apo problemin që dëshiron të shtjellojë) dhe çfarë nuk është trajtuar ende në mënyrë sistematike, apo cilat pyetje kanë mbetur pa përgjigje.

Si rrjedhim, kandidati/ja duhet të vendosë se cilat "shkolla teorike", paradigma dhe koncepte teorike janë të përafërta me problemin që ka parashtruar dhe mbështesin më së miri hulumtimin e tij/e saj. Më konkretisht ky kapitull duhet të përfshijë analizën e literaturës së përzgjedhur, për shembull: një paraqitje të ngjeshur të teorive/autorëve kryesorë dhe të monografive më të rëndësishme shkencore në fushën e caktuar, citime të rëndësishme, etj. Po ashtu, duhet bërë e qartë se pse këto teori janë të rëndësishme dhe të dobishme për hulumtimin e planifikuar.



Gjatë përgatitjes së këtij propozimi rekomandohet që kandidati të bashkëpunojë ngushtë me udhëheqësin e tij/saj. Po ashtu është me rëndësi të theksohet se në këtë fazë të punimit kandidati e kupton qartë përse disa nga kurset teorike në fillim të studimeve të masterit janë kaq të rëndësishme. Prandaj, ia vlen të investohet kohë dhe energji që prej ditës së parë të studimeve master.

Formulimi i problemit dhe qëllimeve të hulumtimit: Problemi shkencor duhet të përkufizohet qartë, saktë dhe mirë. Qëllimet e hulumtimit duhet të jenë të harmonizuara me problemin. Parashtrimi i problemit dhe nëse ai qëndron si i tillë duhet të jenë të lidhura kuptimisht me qasjen teorike, por edhe me hipotezat dhe metodat e parashikuara të kërkimit. Një gabim i shpeshtë (apo një pikë e dobët) në hartimin e projekt-propozimit të punimit të diplomës është që formulimet e këtij kapitulli nuk lidhen (apo nuk balancohen) me formulimet në kapitujt e tjerë, p.sh.me pjesën teorike, me hipotezat e parashtruara, me procedurat e zgjedhura metodologjike, etj. Kjo pjesë kërkon gjithashtu edhe një shpjegim të shkurtër të koncepteve kryesore që përdoren në punimin e diplomës së masterit. Së fundi, kërkohet edhe paraqitja shkurt e strukturës së punimit të diplomës së masterit, si edhe një përmbledhje e shkurtër ku parashtrohen arsyet për zgjedhjen e një strukture të tillë.

Pyetjet e hulumtimit dhe hipoteza: Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat duhet të formulohen në mënyrë që parimisht të mundësojnë vërtetimin dhe verifikimin/hedhjen poshtë të tyre. Pyetja e hulumtimit duhet të formulohet qartë dhe duhet të sigurojë një linjë premtuese të hulumtimit në lidhje me një problem apo çështje të caktuar arsimore që paraqet interes. Ajo duhet të nënkuptojë një hipotezë hulumtimi që mund të verifikohet.

Hipoteza e hulumtimit duhet të jetë e formuluar saktë, në mënyrë që të shmanget dykuptimësia dhe kërkesat shtesë. Një hipotezë që nuk mund të vërtetohet apo të hidhet poshtë nuk është hipotezë. Në kërkimet empirike pyetja dhe hipoteza e nënkuptuar duhet të lidhen me dukuri të matshme dhe kandidati duhet të jetë në dijeni të mjeteve të duhura që mundësojnë matjen. Është e rëndësishme që gjetjet të paraqiten në mënyrë të tillë që mund të arrihet në përfundime.

Duhet të përcaktohen kritere të qarta dhe të pakontestueshme që e vërtetojnë ose e mohojnë një hipotezë. Në kërkimet cilësore është e rëndësishme që të kuptohen drejt dukuritë e hulumtuara dhe të tregohet se përvojat që pasqyrohen në to ndihmojnë të kuptuarit dhe lejojnë mbërritjen në përfundime të caktuara. Nëse përdorim kërkime sasiore apo një përzierje të të dyjave është gjithashtu e rëndësishme të përcaktohet një numër kriteresh përmes së cilave një hipotezë pohohet ose mohohet.



Metodat dhe teknikat e hulumtimit: Në nivelin master i shkencave, kërkohet të paraqiten pyetje kërkimore sfiduese dhe, si rrjedhojë, duhet të zbatohen metodologji më të sofistikuara. Kurse të vecanta të nivelit master kanë për qëllim ta njohin kandidatin me këto metodologji. Ndonjëherë, përveç bashkëpunimit të ngushtë me udhëheqësin, rekomandohet bashkëpunimi edhe me ekspertë të tjerë.

Para së gjithash kandidati duhet të përkufizojë llojin e qasjes kërkimore për problemin e zgjedhur. Në rastet kur tema e kërkimit është kryesisht teorike dhe nuk kërkon metodologji empirike, ky kapitull përfshin zakonisht këto elemente:

- Grumbullimin dhe përzgjedhjen e materialit (literaturës, dokumenteve, fotografive, etj.);
- Përshkrimin e materialit të grumbulluar (theksi vihet në idetë, format, historinë, etj.)
- Metodat që do të zbatohen (historike, krahasuese, fenomenologjike etj.)

Në rastet kur tema e hulumtimit kërkon metodologji empirike, ajo përfshin elemente të tilla, si p.sh. një përshkrim të kampionit të përzgjedhur, instrumentet e matjes, procedurat e mbledhjes së të dhënave, përpunim statistikor, etj.

Rekomandohet që kjo pjesë të përbëhet nga disa paragrafe, p.sh:

- Kampioni: çfarë lloj kampioni do të përdoret; karakteristikat dhe parametrat kryesore;
- Instrumentet matës: kush i ka zhvilluar ato dhe kur; karakteristikat, vlerësimi;
- Procedurat dhe kushtet e mbledhjes së të dhënave; metodat e përdorura;
- Përpunimi statistikor (përse; cilat hipoteza do të vërtetohen, etj.).

Kandidatët që do të punojnë me **pyetësore** dhe **intervista** duhet:

- (1) të sigurojnë pëlqimin e (udhëheqësit) të tyre;
- (2) të përcaktojnë shpenzimet dhe kohën e kryerjes së studimit të propozuar.

Rezultatet e pritshme të hulumtimit: Rezultatet e pritshme duhet të parashtrohen në raport duke u mbështetur në kapitujt e mëparshëm. Po ashtu, rekomandohet që kandidati t'i paraqesë pritshmëritë e veta si pjesë e kontributit të tij në njohuritë, teorinë e praktikën ekzistuese në një fushë të caktuar.

Referencat dhe bibliografia: Në këtë pikë mund të ekzistojnë dy lloj dobësish: bibliografia e zgjeruar ose e mangët. Në përgjithësi, kërkohet vetëm literatura kryesore, si ajo vendore (në gjuhën kombëtare), ashtu edhe ndërkombëtare profesionale (në gjuhë të huaj, revista shkencore, monografi, etj.). Duhet të mbizotërojë literatura e kohëve të fundit (megjithatë, në rastet kur problemet teorike shtjellohen gjerësisht, përfshirja e literaturës "klasike" në bibliografi është "e



domosdoshme"). Në pjesën më të madhe të rasteve mjaftojnë 25 deri 50 burime bibliografike, pasi duhet të dimë se punimi shkencor i masterit nuk është një përshkrim sistematik i një fushe të caktuar; ajo duhet të përqëndrohet veçanërisht në një problem të caktuar. Megjithatë, në disa raste (p.sh. përdorimi i zgjeruar i dokumenteve historike, metodologjive krahasuese; materialet e shkëputura nga artikujt e mediave, etj.) mund të ketë më shumë se 50 zëra bibliografike, parimi është që çdo burim bibliografik i përdorur (përmendur apo cituar) në punim, duhet të vendoset në bibliografi nëse është cituar në atë punim. Sërisht konsultimi me udhëheqësin është i domosdoshëm.

Bibliografia duhet organizuar mirë. Ka disa mënyra për ta realizuar këtë detyrë dhe nuk ka një mënyrë që të quhet si më e mira. Disiplinat dallojnë nga njëra tjetra (për shembull psikologjia nga historia dhe kimia) kështu që rekomandohet të përdoret lloji që është më i përshtatshëm sipas fushës në të cilën zhvillohet kërkimi. E rëndësishme është se nëse një lloj mënyre e bibliografisë është zgjedhur, duhet përdorur sistematikisht ajo mënyrë.

Ka shumë mënyra të ndryshme për të cituar burime nga kërkimi juaj. Stili i citimit nganjëherë varet nga disiplina akademike.

Për shembull:

- APA (Shoqata Amerikane e Psikologjisë) përdoret nga fushat e Arsimit, Psikologjia dhe Shkencat;
- Stili MLA (Shoqata e Gjuhëve Moderne) përdoret nga Shkencat Humane;

Stili i citimit në tekst të APA-së përdor mbiemrin e autorit dhe vitin e botimit, për shembull: (Field, 2005). Për kuotimet e drejtpërdrejta, përfshinin gjithashtu numrin e faqes, për shembull: (Field, 2005, f. 14). Për burime të tilla si faqet e internetit dhe për e-librat që nuk kanë numër faqe, përdorni një numër paragrafi, për shembull: (Field, 2005, para. 1).

Në stilin MLA, referimi i punëve të tjerëve në tekstin tuaj bëhet duke përdorur citime me kllapa. Kjo metodë përfshin sigurimin e informacionit përkatës të burimit në kllapa sa herë që një fjali përdor një citim ose perifrëzim. Zakonisht, mënyra më e thjeshtë për ta bërë këtë është vendosja e të gjithë informacionit burimor në kllapa në fund të fjalisë (d.m.th. pak para pikës).

Formati LA ndjek metodën e shënimit të autorit dhe faqes kur bëhet citimi në tekst. Për shembull:

Wordsworth deklaroi se poezia romantike u shënuar nga një "tejm bushje spontane e ndjenjave të fuqishme" (263).



Poezia romantike karakterizohet nga "tejmushja spontane e ndjenjave të fuqishme" (Wordsworth 263).

Wordsworth eksplori gjerësisht rolin e emocioneve në procesin krijues (263).

Vepra: Wordsworth, William. Balada lirike. Oxford UP, 1967.

Kërkesa teknike për tezën, Formati: Punimi i tezës duhet të respektojë kërkesat e formatit. Nëse punimi nuk prezantohet sipas formatit të kërkuar, ai nuk pranohet deri sa të plotësohen të gjitha kërkesat e formatit.

Lidhja: Dy kopje të tezës duhet të lidhen. Njëra prej kopjeve duhet të jetë origjinalja. Në kopertinë duhet të vendoset emri i universitetit, i programit, titulli i plotë i temës, emri i kandidatit, emri i udhëheqësit shkencor, viti i mbrojtjes. Secili departament përcakton ngjyrën e sfondit të kopertinës dhe të shkronjave.

Pjesa e pasme e kopertinës duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e ballinës dhe duhet të përmbajë:

Abstraktin në shqip, anglisht dhe në Gjuhën B të studimit, me rreth 200 fjalë. Përdoret madhësia 10-she e shkronjave. Ky element duhet t'u mundësojë lexuesve vendas dhe të huaj të kuptojnë se si është trajtuar çështja e marrë në studim. Abstrakti në anglisht është një kërkesë e standardeve ndërkombëtare.

Fushën dhe fjalët kyçe. Studenti në bashkëpunim me udhëheqësin përcakton fushën dhe zgjedh fjalët kyçe në funksion të përshtatshmërisë së tyre me terminologjinë e përdorur në disiplinën përkatëse. Ato ndihmojnë identifikimin e tezës midis katalogjeve kolektive në biblioteka. Shih formatin e ballinës dhe të pjesës së pasme të kopertinës bashkangjitur në këtë Rregullore (Shtojca 2).

Lloji i letrës

Duhet përdorur letër e cilësisë së lartë, e bardhë, format A4.

Shtypja

Materiali duhet të shtypet vetëm nga njëra anë e letrës. Të gjitha kopjet e studimit duhet të jenë të shtypura me kompjuter, të printuara qartë dhe të jenë të lexueshme lehtësisht. Dorëshkrimet nuk pranohen.

Cilësia e shtypjes

Teksti duhet të shtypet me hapësirë dy ndërmjet radhëve, hapësira njëshe do të përdoret për përgatitjen e tabelave të gjata, të ekstrakteve, të shënimeve, të shpjegimeve të gjata dhe të listës së bibliografisë. Vetëm një lloj shkrimi duhet përdorur. Lloji i shkrimit duhet të jetë Times New Roman. Masa e shkronjës duhet të jetë 12-she.



Marxhinat

Marxhinat për të gjithë tekstin do të jenë:

Marxhina e sipërme: 1 "

Marxhina e poshtme: 1 "

Marxhina e majtë: 1.25"

Marxhina e djathtë: 1.25"

Numrat e faqeve

Të gjitha numrat e faqeve duhet të vendosen poshtë dhe në mes të faqes. Hyrja duhet të ketë numra romake. Pjesa e studimit duhet të ketë numra arabë. Faqet e bibliografisë, shtojcave duhet të numërohen me numra arabë në vijim të numrave të tekstit.

Shënimet

Në shkencat sociale dhe humane përdoren gjerësisht shënimet. Studentët këshillohen të përdorin referenca të botimeve të ndryshme të fushës, të raporteve ose të disertacioneve të kandidatëve të suksesshëm të cilat mund të gjenden në biblioteka.

Madhësia e shkronjave të shënimeve është më e vogël se ajo e tekstit. Shënimet në fund të faqes si dhe të gjitha llojet e tjera të shënimeve duhet të shkruhen me shkronja me madhësi 10-she.

Tabelat

Tabelat është mirë të përfshihen në tekst. Tabelat duhet të vendosen në qendër të faqes, brenda marxhinave të caktuara. Çdo tabelë i duhet vendosur një numër referimi me numër arab. Numri i tabelës duhet të ndjekë numrin e kapitullit të cilit i përket. Fjala "tabelë", numri i tabelës dhe legjenda duhet të vendosen në krye të tabelës. Shkrimi duhet të jetë Times New Roman, 12, bold. Nëse tabela vazhdon në faqen tjetër legjenda nuk përsëritet. Nëse një tabelë përmban citate, referencat duhet të theksohen.

Diagramet

Nëse diagramet paraqiten si fotografi, duhet të vendosen në faqen përkatëse; ilustrimet ose grafikët nuk e ndjekin tekstin ose tabelën gjithmonë.

Fjala "figurë", numri i diagramës me numër arab dhe shpjegimet duhet të vendosen poshtë diagramës. Përgjithësisht, një diagramë nuk duhet ta kalojë një faqe. Nëse diagrama vazhdon në faqen tjetër, duhet të ndiqet rregulli për tabelat. Si edhe tabelat, diagramet duhet të mblidhen bashkë dhe t'u vihen numra vijues.

Fotografitë që janë më të vogla se një faqe duhet të vendosen në faqen përkatëse.

Materialet shoqëruese

Nëse një punim përmban materiale shoqëruese të tilla, si: disketa kompjuteri, video ose kaseta, etj që janë një pjesë e rëndësishme e punimit, ato duhet t'i bashkëngjiten punimit.



NENI 19

Afatet e dorëzimit të punimit të diplomës

Afatet e detajuara përcaktohen nga çdo njësi bazë në fillim të çdo viti akademik në përputhje me strukturën akademike. Si rregull i përgjithshëm, ndiqen fazat e mëposhtme:

- **Faza 1:** Departamenti dërgon në fillim të vitit akademik, deri më 15 nëntor, njoftimin tek studentët për hapjen e procedurave të temës së diplomës, përzgjedhjes së temës dhe përzgjedhjes së pedagogut udhëheqës. Në e-mailin e dërguar, specifikohen: emri dhe mbiemri i personelit akademik, titulli/gradat shkencore si edhe fushat përkatëse të kërkimit shkencor.
- **Faza 2:** Studentët konfirmojnë duke dërguar në e-mailin e departamentit, temën e diplomës, pedagogun udhëheqës.
- **Faza 3:** Studentët dorëzojnë në adresën elektronike të pedagogut udhëheqës strukturën e plotësuar të punimit dhe bibliografinë e projektit të kërkimit.
- **Faza 4:** Studentët dorëzojnë në adresën elektronike të pedagogut udhëheqës gjysmën e punimit.
- **Faza 5:** Studentët dorëzojnë në adresën elektronike të pedagogut udhëheqës punimin e plotë.
- **Faza 6:** Pedagogu udhëheqës bën vërejtjet përfundimtare si dhe përgatit lejen e mbrojtjes për studentët (Shtojca 4).
- **Faza 7:** Studentët dorëzojnë pranë departamentit 3 (tre) kopje të shtypura të punimit, 1 CD me variantin elektronik, si edhe lejen e mbrojtjes nga pedagogu udhëheqës.
- **Faza 8:** Zhvillohet mbrojtja e diplomës.

NENI 20

Etika e kërkimit dhe pronësia intelektuale

Është me rëndësi që studentët të marrin parasysh standardet e etikës profesionale dhe t'i respektojnë ato në auditor dhe në mjedisin ku kryhet kërkimi, në të kundërt, do të kenë pengesa dhe vështirësi gjatë gjithë procesit të kërkimit. Shpeshherë, mbledhja e të dhënave personale mund të jetë një çështje shumë e ndjeshme për individët apo grupet shoqërore. Po ashtu, kryerja e eksperimenteve të ndryshme apo respektimi i normave ligjore shpeshherë shoqërohen me pengesa të ndryshme. Për këtë arsye është më se e domosdoshme që në çdo fazë të kërkimit të merren parasysh "etika e kërkimit" dhe integriteti akademik.



Parimet kryesore të etikës së kërkimit janë:

- Respektimi i dinjitetit njerëzor (trajtimi i personave në mënyrë të drejtë dhe respektimi i të drejtave të njeriut);
- Qëllimi i mirë, dobia (përpjekje për cilësi dhe përdorim më të mire të burimeve, jo shfrytëzim i pjesëmarrësve të kërkimit etj)
- Drejtësia (rëndësia e paanësisë, përfitimi i barabartë, respektimi i autorësisë, respektimi i individëve apo i grupeve të personave me nevoja të vecanta etj).

Një kërkues ose grup kërkimi duhet të respektojë integritetin akademik dhe të përpiqen:

- të pranojnë, njohin kontributet e burimeve të tjera në përpjekjet e tyre studimore;
- të përfundojnë punën e tyre kërkimore në mënyrë të pavarur;
- të ndjekin udhëzimet për punën kërkimore duke respektuar standardet e disiplinës akademike dhe të shmangin çdo formë mashtrimi akademik.

Në aspektin e etikës së kërkimit, studentët duhet të respektojë sa më poshtë vijon:

- Punimi duhet të jetë punë origjinale e kandidatit. (Shtojca 3)
- Një kandidat nuk lejohet të paraqesë si punim për diplomën master një punim që e ka paraqitur për një gradë tjetër në këtë universitet ose në një universitet tjetër, por kandidati nuk ndalohet të përfshijë pjesë të punës nëse ai tregon qartë cila pjesë e punës është përdorur më parë.
- Një kandidat mund të paraqesë një pjesë kontributi që është botuar më parë individualisht ose në grup. Nëse puna është pjesë e përpjekjeve të një grupi, një shpjegim për pjesën e shkruar nga kandidati duhet të përfshihet në parim.
- Gjatë periudhës së përgatitjes së punimit, kandidati mund të botojë pjesë të studimit shkencor me lejen e udhëheqësit.
- Plagjiatura përfshin përdorimin e ideve dhe të fjalëve nga publikimet e një personi tjetër pa dhënë referencën përkatëse. Kërkohej që të shënohet referenca përkatëse nëse përdoren ide të tjerëve.
- Përdorimi i ideve ose i punës së të tjerëve duhet të evidentohet individualisht në tekst ose secili punim i përdorur duhet të shënohet në listën e referencave ose në bibliografi.
- Të gjitha citimet nga punimet e të tjerëve duhet të vendosen në thonjëza dhe të shënohet burimi.
- Nëse pjesët e marra nga të tjerët janë më të gjata se pesë radhë nuk futen në thonjëza, por shënohet referenca për to.
- Sqarimet e mundshme të kandidatit duhen futur në kllapa katrore.
- Nëse burimi origjinal nuk gjendet dot, por burimi është përmendur në një dokument tjetër, atëherë të dy dokumentet, burimi origjinal dhe burimi dytësor duhet të shënohen.
- Udhëheqësit duhet të sqarojnë që në fillim të punës se asnjë lloj mashtrimi, falsifikimi dhe plagjiature nuk do të tolerohet, por përkundrazi për to ka ndëshkime të ndryshme.



Pandershmëria akademike e cila përfshin deklarime false, të dhëna të rreme, prezantimi i punës së grupit si punë individuale dhe plagjiatura i duhen shpjeguar studentit.

- Megjithatë, rastet e mosrespektimit të rregullave të citimeve për shkak të pakujdesisë ose të mosdijes do të dallohen nga ato ku pandershmëria është e dukshme dhe e qartë.
- Në rastet kur pandershmëria akademike ka ndodhur, kjo i bëhet e ditur titullarit të njësisë bazë për veprime të mëtejshme.

Pronësia intelektuale

- E drejta e autorit për punimin (si edhe për një material të botuar) mbrohet nga ligji ndërkombëtar i së drejtës së autorit. Shënimi për rezervimin e të drejtës së autorit, simboli përkates, emri i zotëruesit të autorësisë, viti i punimit duhet të vendoset në faqen që vjen pas titullit të punimit.

NENI 21

Dispozita të fundit

Me miratimin e Rregullores së Diplomimit në Programet studimore të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në Fakultetin e Gjuhëve të huaja, ajo bëhet pjesë e rregulloreve të Programit Mësimor të programeve të studimit, që prej miratimit të tyre (2008-2018).



SHTOJCA

Shtojca 1: Projekt-propozim për punimin kërkimor

Shtojca 2: Format i ballinës dhe faqes së pasme të punimit

Shtojca 3: Deklaratë autorësie

Shtojca 4: Leje për mbrojtjen e punimit të diplomës

Shtojca 5: Vlerësimi i udhëheqësit shkencor

Shtojca 6: Fletë vlerësimi



Shtojca 1

PROJEKT-PROPOZIM PËR TEZËN

1. Të dhëna të përgjithshme

Emri i studentit: _____

Programi i studimit: _____

Udhëheqësi i propozuar _____

2. Përshkrimi i projekt-propozimit

2.1.1 Titulli i temës

2.1.2 Abstrakti

2.1.3 Fjalët kyçe

2.1.4 Hyrja

2.1.5 Sfondi teorik

2.1.6 Formulimi i problemit dhe qëllimet e hulumtimit

2.1.7 Pyetjet dhe hipoteza e hulumtimit

2.1.8 Metododat dhe teknikat e hulumtimit

2.1.9 Rezultatet e hulumtimit

2.1.10 Literatura

Shënim zyrtar:

Vendimi i marrë nga komisioni përgjegjës(emri i komisionit)
më _____ (datë)

Studenti _____ lejohet të kryejë punimin shkencor me temë

Udhëheqësi i tij/ saj shkencor do të jetë:

(Firma e personit përgjegjës)



Shtojca 2

UNIVERSITETI I TIRANËS

FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

DEPARTAMENTI _____

PROGRAMI (Titulli i programit të studimit)

(Times New Roman 12, kapitale)

TITULLI I TEMËS

(Times New Roman 14, kapitale)

Paraqitur në kërkim të diplomës “Master i Shkencave” në

Punuar nga: (emër mbiemër i studentit)

Udhëhequr nga: (Prof.) Dr. (emër mbiemër i udhëheqësit)

(Times New Roman, masa e shkrimit 12)

Tiranë, më

Faqja e pasme e punimit:

TITULLI:

ABSTRAKT:

FUSHA E STUDIMIT:

FJALËT KYÇE:

ADRESË:



Shtojca 3

DEKLARATË AUTORËSIE

Unë, _____ nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim me titull: _____, është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

_____,

(emri i studentit dhe nënshkrimi i tij)

Tiranë, më _____



Shtojca 4

UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI _____

Tiranë, më _____

DEKLARATË E UDHËHEQËSIT

Unë i/e nënshkruari/a _____ jap miratimin tim që
studenti _____ , të mbrojë temën e Masterit në
dt. _____ .

Deklaruesi

(Emër , mbiemër, firmë)



Shtojca 5

UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI _____

PROGRAMI I STUDIMIT:

VLERËSIM I UDHËHEQËSIT SHKENCOR PËR PUNIMIN E DIPLOMES ME TEMË:

PËRGATITUR NGA:

UDHËHEQËSI SHKENCOR:

Tiranë, më _____



Shtojca 6

UNIVERSITETI I TIRANËS FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA DEPARTAMENTI _____

PROGRAMI I STUDIMIT:

FLETË VLERËSIMI PËR PUNIMIN E DIPLOMËS "MASTER I SHKENCAVE" NË (emërtimi i plotë i programit të studimit)"

Emri i studentit: _____

NIM i studentit: _____

Titulli i temës së punimit: _____

Nr.	Kriteret e vlerësimit	Pikët e parashikuara	Pikët e fituara
1	Demonstrimi i një vetëdije profesionale në trajtimin e çështjes së zgjedhur (përcaktimi dhe trajtimi i çështjes së zgjedhur (përcaktimi i qartë i çështjes kërkimore, përputhja e trajtesës me temën, përshkrimi dhe analiza e thellë e rezultateve, paraqitja e përfundimeve dhe rekomandimeve)	25	
2	Përdorimi i metodologjisë shkencore dhe i instrumenteve të kërkimit (përcaktimi i detyrës shkencore në përputhje me temën, përcaktimi i hipotezave ose i pyetjeve kërkimore, përcaktim i subjekteve, i kampionit, përzgjedhja e metodave dhe e instrumenteve të përshtatshëm)	15	
3	Origjinaliteti i punimit (formulimi origjinal i temës, këndvështrimi origjinal i temës, struktura origjinale, rezultate dhe analiza origjinale)	20	
4	Dobia e punimit (dobia e punimit për zhvillimin e teorisë, për zbatimin në praktikë, për studime të mëtejshme)	15	
5	Cilësia e të shkruarit (respektimi i stilit shkencor të të shkruarit dhe i rregullave të drejtshkrimit)	10	
6	Paraqitja teknike (respektimi i kërkesave teknike të formatit të punimit)	5	
7	Cilësia e prezantimit	10	
8	SHUMA E PIKËVE	100	

Komisioni i vlerësimit

1. _____
2. _____
3. _____

Datë _____



Miratoi

Dekani

Prof. Dr. Esmeralda Kromidha

